



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.234/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Faton Ademi dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fatjona Bekteshi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Ertan Simitçi nga Prizreni, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike Turke e Kosovës (KDTP), me seli në Prizren, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 06 tetor 2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.10.2019, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** e pabazuar ankesa Anr.234/2019 e datës 05.10.2019, e paraqitur nga Ertan Simitçi nga Prizreni, kundër subjektit politik Partia Demokratike Turke e Kosovës (KDTP), me seli në Prizren, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike - vendosja e zyrës në afërsi prej 100 metra afër qendrës së vendvotimit.

## A r s y e t i m

Ertan Simitçi nga Prizreni, më datë 05.10.2019, ka paraqitur ankesë në PZAP, me të cilën pretendon se gati në çdo zgjedhje në qytetin e Prizrenit në lagjen Kurillë, afër shkollës “Motrat Qirijazi”, është një lokal – zyre, të cilën disa kandidatë për deputet nga radhët e subjektit politik KDTP, së bashku me disa njerëz veprojnë me qëllim të ndikimit tek votuesit dhe bëhet presion i madh ndaj qytetarëve, për shkak se nuk mund të lëvizin lirshëm afër shkollës, ky rast është paraqitur edhe në media. Më tutje paraqitësi i ankesës shton se unë si qytetarë kërkoj nga PZAP-i dhe KKZ, që brenda kompetencave ligjore të marrin një veprim ligjor që në ditën e zgjedhjeve të mbyllet kjo zyre e cila përdoret nga ish deputetët e KDTP-së, dhe të sigurohet hapësira për lëvizjen e lirë të qytetarëve, zyra – lokali gjendet afër shkollës “Motrat Qirijazi”, brenda 100 metrave e cila është caktuar me rregullore.

PZAP-i, më datë 05.10.2019, konform nenit 7 par.1 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e njoftoi subjektin politik Partia Demokratike Turke e Kosovës (KDTP), për ankesën e paraqitur, duke i dhënë kohë të përgjigjet deri më datë 06.10.2019 në ora 09:00, mirëpo të njejtit nuk janë përgjigjur brenda afatit të caktuar.

Pretendimet ankimore të paraqitësit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar të Kodit të Mirësjelljes - vendosja e zyrës në afërsi prej 100 metra afër qendrës së vendvotimit, nga ana e subjektit politik Partia Demokratike Turke e Kosovës (KDTP), Paneli i vlerësoj se janë të

pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se paraqitësi i ankesës nuk ka arritur që të argumentojë me prova bindëse pretendimet e tij ashtu siç parashihet me nenin 117 par.3 të LZP-së në mënyrë që paneli, të merr vendim në favor të tij.

Nga arsyet e theksuara më lartë, e duke u bazuar në nenin 115 par.1 dhe nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Anr.234/2019 më datën 05.10.2019**

**Kryesues i Panelit**  
**Adnan Konushevi**



*Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.3 të LZP-së.*